



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:187335

Datë: 09.12.2021

Numri i dokumentit: 02493446

C.nr.1021/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me zyrtares ligjore Albana Curri, në çështjen kontestimore të paditëses E. G. nga Gjakova, rruga “. . .” pa nr., të cilën me autorizim e përfaqëson Ylli Bokshi - avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, vlera e kontestit 1,780,20 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me 30 nëntor 2021, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të te paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E. G. nga Gjakova nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 734 ditë pune, për periudhën kohore 01.09.2016 – 29.02.2020, të ia paguajë shumën prej 1,468.00 euro (një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), si dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore 01.09.2016 – 22.11.2018, të ia paguajë shumën prej 312,00 euro (treqind e dymbëdhjetë euro), përkatësisht shumën e përgjithshme prej **1,780,20 euro** (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë euro e njëzetë cent), me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data 30.11.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej **279,20 euro** (dyqind shtatëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datë 29.12.2020, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike: kompensim i ushqimit gjatë punës dhe shpenzime të udhëtimit. Ka shtuar se paditësja është e punësuar te e paditura si mësimdhënëse e matematikës. E paditura, në bazë të nenit 36 paragraf 6 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, e nënshkruar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe SBASHK, datë 11.04.2014 dhe në bazë të nenit 35 paragraf 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe SBASHK, datë 18.04.2017, është e obliguar që punëtorëve të arsimit, të i kompensojë ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2 euro për çdo ditë në punë si dhe shpenzimet e transportit. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontratat e lartpërmendura, nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësja ka qenë e detyruar që të parashtronte padi – kërkesëpadi dhe të kërkojë realizimin e të drejtës së saj subjektive.

I autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, provave të bashkangjitura në padi ashtu që gjykatës i ka propozuar që e njëjtat te administrohen ashtu që nga administrimi i tyre nën ndërlidhje me kontratat kolektive kërkesëpadija do të vërtetohet në tërësi si e bazuar. Ka shtuar se e paditura nuk ka ushtruar përgjigje në padi, ashtu që e njëjta nuk e ka kundërshtuar bazën apo lartësinë e kërkesëpadisë. Në rastin konkret e ka bërë precizimin e kërkesëpadijës, për shpenzimet e ushqimit në vendin e punës si dhe shpenzimet e udhëtimit, pasi që në bazë të njoftimit të lëshuar nga SHFMU “7 Shtatori” nga fshati Gërquinë, rrjedhë se paditësja ka punuar nga data 01.09.2016 deri me datë 22.11.2018, kërkojmë që paditëses në bazë krahasore me vërtetimet e shkollës Mazllum Këpuska për vitin shkollorë 2016/2017, të i kompensohet shujta dhe shpenzimet e udhëtimit për 223 ditë të pranisë në punë. Në bazë të vërtetimit të shoqatës së transportit të udhëtarëve bileta e autobusit kushton 1,00 euro dhe paditësja në fshatin Gërquinë ka udhëtuar për 223 ditë pune, ashtu që për vajtje - ardhje ka paguar çmimin e biletës 2,00 euro, e që konform kontratave kolektive e paditura ka pasur për obligim ti paguaj 70 % të shpenzimeve të udhëtimit, ashtu që për këtë kriter kërkojmë 312,20 euro ndërsa sa i përket shpenzimeve të ushqimit paditësja në total ka vijuar punën për 734 ditë të pranisë në punë nga data 01.09.2016 e deri me datë 29.02.2020, e duke pasur parasysh që e paditura ka pasur për obligim paditëses ti paguaj 2,00 euro për çdo ditë të paraqitjes në punë, për këtë kriter të kontratës kolektive kërkojmë shumën 1,468.00 euro. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fillimisht e bëjë precizimin e kërkesëpadisë dhe atë: detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës –DKA në Gjakovë që paditëses E.G. nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore nga 01.09.2016 e deri me 29.02.2020 t’i paguaj shumën prej 1,468.00 euro dhe për shpenzimet e udhëtimit për periudhën prej 01.09.2016 e deri me 22.11.2018 t’i paguaj shumën prej 312,20 euro, në shumën e përgjithshme prej 1,780.20 euro me kamatë ligjore prej 8%,,duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit. Në bazë të provave të administruara padia dhe kërkesa e saj është e bazuar, me propozim për gjykatën që e njëjta të aprovohet në tërësi si e themeltë. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në lartësinë prej 40,00 euro, për përpilimin e padisë vlerën prej 104,00 euro, si dhe për përfaqësim në shqyrtimin kryesor, shumën prej 135,20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 279,20 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 25.01.2021 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 04.02.2021 (siç vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo nuk ka parashtruar fare përgjigjen në padi.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt, me ç’rast pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadija e precizuar e paditëses, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: kontratës së punës e lidhur në mes të paditëses E. G. dhe të paditurës Komuna e Gjakovës me datë 03.09.2018, e legalizuar nën LEG nr.2798/20, datë 19.10.2020, kontratës së punës e lidhur në mes të paditëses E. G. dhe të paditurës Komuna e Gjakovës, me datë 21.11.2017, e legalizuar nën LEG nr.2799/20, datë 19.10.2020, kontratës së punës e lidhur në mes të paditëses E. G. dhe të paditurës Komuna e Gjakovës me datë 07.09.2016, e legalizuar nën LEG nr.3009/2020, datë

09.11.2020, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Mazllum Këpuska” numër 92-1/2020, datë 07.10.2020, e nënshkruar nga Drejtori A. P., njoftimi lëshuar nga SHFMU “7 Shtatori” Gërquinë, numër 433, datë 18.05.2018, e nënshkruar nga Drejtori Rustem Gjuraj, vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit Gjakovë me datë 10.11.2020, e nënshkruar nga Kryetari Kadri Rrahmani.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Me kontratën e punës me nr. të prot. 22, datë 07.09.2016, nën LEG nr.3009/20, datë 09.11.2020, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, gjykata ka provuar faktin se këtu paditësja E. G. ka lidhur kontratë pune me të paditurën, përkatësisht shkollën “7 Shtatori” në Gërquinë, pozita: mësimdhënëse, lënda: matematikë, me kohëzgjatje të kontratës 01.09.2016 - 31.08.2017.

Nga kontrata tjetër e punës me nr. të prot.176, datë 21.11.2017, e legalizuar nën LEG nr.2799/20, datë 19.10.2020, gjykata ka provuar faktin se këtu paditësja E. G. ka lidhur kontratë pune me të paditurën, përkatësisht shkollën “Mazllum Këpuska” në Gjakovë, pozita: mësimdhënëse, lënda: matematikë, me kohëzgjatje të kontratës 21.11.2017 - 31.08.2018.

Me kontratën e punës me nr. të prot.176, datë 03.09.2018, nën LEG nr.2798/20, datë 19.10.2020, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, gjykata ka provuar faktin se këtu paditësja E. G. ka lidhur kontratë pune me të paditurën, përkatësisht shkollën “Mazllum Këpuska” në Gjakovë, pozita: mësimdhënëse, lënda: matematikë, me kohëzgjatje të kontratës 01.09.2018 - e përhershme.

Me vërtetimi numër 92-1/2020, i lëshuar me datë 07.10.2020 nga SHFMU “Mazllum Këpuska” (e nënshkruar nga Drejtori i shkollës A. P.), provohet se këtu paditësja në vitin shkollor 2017/2018, ka vijuar 165 ditë pune, në vitin shkollor 2018/2019, ka vijuar 222 ditë pune, në vitin shkollor 2019/2020, ka vijuar 124 ditë pune.

Nga njoftimi numër 433, lëshuar me datë 18.05.2018 nga SHFMU “7 Shtatori” Gërquinë, vërtetohet se këtu paditësja në institucionin e lartcekur ka filluar punën me datë 01.09.2016 deri me datë 22.11.2018, ka përvojë pune 1 vit, 3 muaj dhe 22 ditë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit Gjakovë me datë 10.11.2020, e nënshkruar nga Kryetari Kadri Rrahmani, provohet rrethana se çmimi i biletës së relacionit Gjakovë – Gërquinë, kushton 1,00 euro (në një drejtim).

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 36 par. 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 11.04.2014, me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve, iu sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë të pranisë në punë, është së paku 2 (dy) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për t’a bërë kompensimin”* si dhe nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, në të cilat në mënyrë identike është paraparë kompensimi i ushqimit në punë, ashtu që duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të te punësuarve në vendpunimin – objektin ku ka punuar këtu paditësja), si dhe duke u bazuar në Kontratën e punës nga të cilat është vërtetuar fakti se

këtu paditësja ka është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa vërtetimet e lëshuar nga SHFMU “7 Shtatori” Gërquinë si dhe SHFMU ”Mazllum Këpuska në Gjakovë, vërtetojnë ditët e prezencës në punë të paditësës (734 ditë pune), erdhi në përfundim se kërkesa e precizuar e paditësës lidhur me një kompensim të këtyllë është e themeltë ($734 \times 2 = 1,468.00$) për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës tjetër të paditësës e cila i referohet shpenzimeve të udhëtimit nga vendbanimi i saj Gjakovë, e deri në vend punimin e saj - në shkollën “7 Shtatori” Gërquinë, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 36 par. 6 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 11.04.2014, me të cilën është paraparë se: *“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”* si dhe me nenin 35 par. 5 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, ku në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Me rastin e vendosjes gjykata pati parasysh njoftimin numër 433, lëshuar me datë 18.05.2018 nga SHFMU “7 Shtatori” Gërquinë, për ditët e prezencës në punë, si dhe vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë me datë 10.11.2020, ku janë vërtetuar ditët e prezencës në punë të paditësës (223 ditë pune) si dhe çmimet e biletës së udhëtimit në relacionet e sipërpërmendura (1,00 euro në një drejtim), e duke i marrë parasysh ditët e pranisë në punë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditësës në raport me shpenzimet e udhëtimit është e bazuar ($223 \times 1,40 = 312,20$) për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësës në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *“Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e ushqimit në punë që ka pasur ndaj këtu paditësës, gjykata vlerëson se përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësës iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 40,00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104,00 euro, dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të saj në shqyrtimin kryesor, shuma prej 135,20 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 279,20 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1021/20, me 30 nëntor 2021

Gj y q t a r i
Malsor Kryeziu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.